

---

*Treguesit për caktimin e normës në % të shtesës kundërciklike të kapitalit (KUNC)*

---

Në përputhje me rregulloren “Për shtesat makroprudenciale të kapitalit” miratuar me vendimin nr.41, datë 05.06.2019 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë dhe udhëzimet e Bordit Evropian të Rrezikut Sistemik, për përcaktimin e normës së shtesës kundërciklike të kapitalit përdoren treguesit e referencës. Këta tregues synojnë të reflektojnë në mënyrë sa më të drejtë ciklin e kreditimit dhe rreziqet që shoqërojnë rritjen e tepërt të kreditimit në vend, si edhe të konsiderojnë në mënyrë të përshtatshme specifikat e ekonomisë së vendit. Vlerat sasiore të treguesve janë gjithmonë subjekt i interpretimit dhe analizës së ekspertëve të cilët në analizë mund të përfshijnë edhe faktorë të tjerë cilësorë.

Midis treguesve të referencës, si *tregues parësor* shërben “Hendeku i raportit të kredisë për ekonominë ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB)”, që paraqet devijimin e vlerës aktuale të raportit “Kredi për ekonominë/PBB” nga prirja e tij afatgjatë. Ky tregues sinjalizon mundësinë e rritjes së tepërt të kreditimit në raport me rritjen ekonomike dhe eventualisht, rritjen e rreziqeve sistemike ciklike. Si *plotësues* të treguesit parësor, shërbejnë disa nëntregues të tjerë të grupuar në indeksin e treguesit të paralajmërimit të hershëm (TPHP). Krahas treguesit parësor, ky tregues përbëhet edhe nga pesë nëntregues të tjerë të cilët sinjalizojnë zhvillimet në kreditim dhe në aktivet jofinanciare (tregu i pasurive të paluajtshme).

---

*Arsyetimi mbi caktimin e normës në % të KUNC*

---

Tabelat në vijim paraqesin vlerat më të fundit të disponueshme të treguesve të përzgjedhur dhe mesataret historike përkatëse.

Nga tabela 1, vërehet që shifra e treguesit parësor vijon të regjistrojë vlera negative dhe ende larg vlerave të pragut krahasues që, si rregull, do të shoqërohej me rritjen e normës së shtesës kundërciklike të kapitalit<sup>i</sup>. Vlera e treguesit është ngushtuar kundrejt të njëjtës periudhë një vit më parë por është zgjeruar ndaj tremujorit paraardhës.<sup>ii</sup>


*Tabelë 1. Treguesi parësor*

Treguesi parësor <sup>iii</sup>	Mesatarja historike		T3-2022
	T4-2002 : T4-2008	T1-2009 : T2-2022	
<i>Hendeku i kredisë për ekonominë ndaj PBB-së<sup>iv</sup></i>	1.9 pp	-7.8 pp	-7.6 pp <sup>v</sup>

*Burimi: Banka e Shqipërisë dhe INSTAT.*

Zhvillimet tremujore reflektojnë ritmin më të lartë rritës të produktit të brendshëm bruto të vjetorizuar, kundrejt ritmit rritës të kredisë për ekonominë. Ecuria e treguesit parësor ka qenë në të njëtin kah për segmentet “biznese” dhe “individë”. Gjatë periudhës në analizë, thellimi i vlerës së treguesit duket se është përcaktuar kryesisht nga ecuria e treguesit përkatës të segmentit “individë”. Megjithatë, në afat të gjatë, vlera e treguesit parësor për segmentin “individë” është më pranë nivelit neutral, duke ruajtur nevojën për një vëmendje të shtuar.

*Grafik 1. Ecuria e hendekut të raportit “Kredi për ekonominë / PBB” në pikë përqindje*



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Vendimarrja e Bankës së Shqipërisë mbi përcaktimin e normës së shtesës kundërciklike të kapitalit merr në konsideratë edhe ecurinë e TPHP.

Ecuria e indeksit dhe e nëntregueve përbërës të tij paraqitet në tabelën në vijim. Zhvillimet e periudhës pasqyrojnë një zgjerim në terma vjetorë të portofolit të kredisë për pasuri të paluajtshme, por me një ritëm më të ngadalësuar dhe duke rënë nën mesataren historike. E njëjta prirje vërehet edhe në terma tremujorë, me ndryshime të vogla. Megjithatë, indeksi i çmimit të banesave ka vijuar rritjen në terma vjetorë dhe tremujorë, duke qëndruar ndjeshëm mbi vlerën e mesatares historike. Ecuria e këtyre dy nëntreguesve, të cilët priren të përforcojnë ecurinë e njëri-tjetrit, po monitorohet me kujdes. Qëllimi është që, duke përdorur edhe informacionet që lidhen me ngarkesën me borxh të familjeve, të identifikohen dhe parandalohen situatat në të cilat ecuria e çmimeve në tregun e pasurive të paluajtshme është e paqëndrueshme. Së fundi, edhe nëntreguesi i intensitetit të kredisë për ekonominë ka shënuar një rritje vjetore, por zhvillimet tremujore nuk shfaqin ndryshime thelbësore.

*Tabelë 2. Treguesit plotësues*


## Dhjetor 2022

Treguesit plotësues dhe indeksi TPHP	Mesatarja historike (T4-2002 : T2-2022)	T3-2022
Intensiteti i kredisë për ekonominë <sup>vi</sup>	3.0%	3.8%
Ndryshimi vjetor i kredisë bankare për pasuri të paluajtshme	20.9%	14.5%
Ndryshimi vjetor i indeksit të “çmim i banesave / vlera e qirasë” <sup>vii</sup>	8.1%	16.2%
Ndryshimi vjetor i indeksit të çmimit të banesave <sup>viii</sup>	5.7%	17.6%
Rritja vjetore e kredisë bankare <sup>ix</sup>	14.5%	12.4%
<b>Indeksi TPHP<sup>x</sup></b>	<b>0.5</b>	<b>0.6</b>

Burimi: Banka e Shqipërisë dhe INSTAT.

Në fund të tremujorit të tretë, vlera e indeksit TPHP qëndron pranë asaj të tremujorit paraardhës dhe mbi vlerën e pragut krahasues. Ndonëse treguesi parësor mbetet në vlera negative, tejkalimi i vlerës së pragut në mënyrë të qëndrueshme nga ana e indeksit plotësues, shton mundësinë e një rritjeje në normën e shtesës kundërciklike të kapitalit.

Grafik 2. Ecuria e Treguesit të Paralajmërimit të Hershëm Plotësues.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Mbështetur në të dhënat dhe analizën e treguesve të mësipërm, rezulton se, pavarësisht disa zhvillimeve në tregues të caktuar që kërkojnë monitorim të kujdesshëm, rreziqet që lidhen me kreditimin e tepërt mbeten ende në nivele të kontrolluara.

Si rezultat norma e shtesës kundërciklike të kapitalit (KUNC) për Shqipërinë, propozohet të vijojë të jetë 0%.

**SQARIME:**

<sup>i</sup> Rritja e shtesës kundërciklike të kapitalit mund të jetë e nevojshme edhe nëse vlerat e treguesit parësor janë më të vogla se pragu krahasues. Ky është rasti kur, pavarësisht ecurisë së kredisë në përgjithësi, vërehen zhvillime të shpejta të kreditimit në sektorë të caktuar, të cilat konsiderohen të paqëndrueshme dhe burim rreziku për qëndrueshmërinë e sistemit financiar dhe të tregjeve.

<sup>ii</sup> Vlera e treguesit parësor ishte: [-7.84] pp në T3-2021, [-7.04] pp në T4-2021, [-7.18] pp në T1-2022 dhe [-7.30] pp në T2-2022.

<sup>iii</sup> Në analizën e vlerave në tabelë, duhet konsideruar që vlerat e llogaritura të treguesit parësor dhe të mesatares së tij historike ndryshojnë për shkak të dy grupeve të faktorëve: a) zhvillimeve në vlerat e kredisë për ekonominë dhe të PBB-së; dhe b) rishikimeve të vlerave të PBB-së që kryen rregullisht Instituti i Statistikave (INSTAT). Këto dy grupe faktorësh mund të ndikojnë mbi vlerën e treguesit parësor, në të njëjtin kah ose në kahe të ndryshme.

<sup>iv</sup> Vlera e PBB-së është llogaritur si shuma e vlerave të katër tremujorëve të fundit. Për T3-2022, norma e rritjes reale të PBB-së është 4.02%. Vlera e rritjes ekonomike të periudhës mund të jetë subjekt rishikimi në periudhën pasardhëse nga INSTAT.

<sup>v</sup> Vlera e treguesit parësor për T3-2022 prej [-7.61] pp shënon një ngushtim (përmirësim) të hendekut të kredisë në krahasim me vlerën e T3-2021 [-7.84].

<sup>vi</sup> Vlera absolute e rritjes vjetore të kredisë për ekonominë si raport ndaj vlerës së vjetorizuar të PBB-së (shuma e vlerave të PBB-së për katër tremujorët e fundit).

<sup>vii</sup> Vlerat e indeksit zbuten për 8 tremujorët e fundit. Në T4-2020, metodologjia e përlllogaritjes të indeksit të qirasë ka ndryshuar duke sjellë edhe ndryshimin e vlerës mesatare historike të tij.

<sup>viii</sup> Vlerat e indeksit zbuten për 8 tremujorët e fundit. Në T2-2019, metodologjia e ndërtimit të indeksit ka ndryshuar duke sjellë edhe ndryshimin e vlerës mesatare historike të tij.

<sup>ix</sup> I referohet totalit të kredisë së dhënë nga sektori bankar për sektorin publik dhe atë privat jofinanciar.

<sup>x</sup> Nëntreguesit individualë, së bashku me treguesin parësor, përbëjnë “Treguesin e Paralajmërimit të Hershëm Plotësues”. Treguesi është ndërtuar në trajtë indeksi dhe secili prej nëntreguesve ka të njëjtën peshë. Pragu krahasues për indeksin TPHP, është përcaktuar në nivelin 0.5. Për më shumë informacion, lutem referojuni metodologjisë “Për Shtesën Kundërciklike të Kapitalit:

[https://www.bankofalbania.org/Stabiliteti\\_Financiar/Politika\\_makroprudenciale/Instrumentet\\_e\\_politikes\\_makroprudenciale/Akte\\_te\\_miratuara/](https://www.bankofalbania.org/Stabiliteti_Financiar/Politika_makroprudenciale/Instrumentet_e_politikes_makroprudenciale/Akte_te_miratuara/).